



Përmbajtja

Projektet e realizuara gjat 2014-ës

Projekti 1 (pakot ushqimore).....	2
Projekti 2 (bursat).....	2
Projekti 3 (Millto Gurra).....	3
Projekti 4 (Manifestimi).....	3

Projektet për të ardhmen

Ndërtimi i shtëpisë.....	4
Mirmbajtja e Varrezave dhe rrugëve.....	4
Buxheti gjat vitit 2014.....	5

GARANA



Shoqata Humanitare

20.02.2015

Raport i përgjithshëm mbi projektet e „Shoqatës Humanitare Garana“ në vitin 2014

Të nderuar antarë dhe bashkatdhetarë

Vitet po kalojnë dhe shoqata jonë e përbashkët tani ka hyrë në vitin e katërt qysh nga themelimi i sajë. Tani, të gjithë jemi duke shijuar frutat e suksesit sajë.

Edhe në vitin 2014, Shoqata ka patur një aktivitet të zgjeruar.

Në vijim keni një rradhitje të projektve gjatë vitit 2014.

1. Shpërndarja e pakove ushqimore

Ky projekt është i një rëndësie të veçantë për Shoqatën dhe që nga fillimi, Shoqata këtë projekt e ka kryer dy herë në vit. Poashtu, edhe në vitin 2014 u shpërndan dy herë nga 13 pako ushqimore, të cilat kapin vlerën e 3000 Franga Zviceriane.

Realizimi i Projektit(2014)

- Gjysëmvjetori i parë: 13 pako ushqimore = 1500 Fr.
- Gjysëmvjetori i dytë: 13 pako ushqimore = 1500 Fr.
- Shuma totale për këtë projekt: 3000Fr.

Në mbledhjen e fundit me antarët e Shoqatës Humanitare Garana, e mbajtur më datë 23.Nëntor 2014 në Aarburg, është marrë vendimi nga antarët, që ky projekt, në vitet e ardhshme të realizohet tre herë brenda vitit.

Vitin e kaluar në këtë projekt kontribuan me 500 Dollarë edhe vllazërit tanë që gjenden në Amerikë.

2. Bursat për studentët e Garanës

- Shoqata Humanitare Garana, me mbështetjen e plotë të antarëve, nga fillimi i vitit 2013 filloj me përkrahjen e tre studentëve apo studenteve të shkëlqyshëm. Përzgjedhja e Studentëve u bë me anë të një konkursi publik. U perzgjodhën kandidatët të cilët i plotësuan të gjitha kushtet e vendosura nga ana e Shoqatës. Secili student apo studente përfitojë shumën prej 1000Fr. për vit akademik.

- Gjatë vitit 2014, njëri nga studentët i përfundoj studimet me sukses të lartë. Nga kjo situatë e re, Shoqata përsëri shpalli konkurs për një Student/e. Në këtë konkurs konkuruan dy Student/e. Duke parë gjendjen e mirë të Shoqatës, kryesia e Shoqatës morri vendimin që të rrisë numrin e bursave nga tre në katër. Kështu që: Në vitin 2015 Shoqata do të japi katër bursa për studentët dhe studentet nga fshati jonë.

Realizimi i projektit (2014)

Bursat u dorëzohen Studentve dy herë në vit(në fillim të semestrit akademik)

- Semestri i parë: 3 Student/e = 1500 Fr.
- Semestri i dytë: 3 Student/e = 1500 Fr.
- Shuma totale për këtë projekt = 3000Fr.

Për vitin akademik 2014/2015, Shoqata ndau bursa për katër student/e.

3. Kontribut në shkollën fillore Millto Gurra

Kontribut me 1000 Fr. ne projektin e Shkolles M.Gurra

- per kyqjen e WC me kanilizimin e fshatit
- per riparimin e rrethojës së arealit të shkollës

4. Organizimin e Manifestimit

Me 2014 SH.H.Garana organizoi manifestimin e dytë rradhasi. Edhe në këtë manifestim ishin të pranishëm artistë nga fshati jonë si, Dervish Dervishi, Argëton Dervishi dhe Rabie Rika. Gjithashtu ne këtë manifestim ishte edhe Duli. Atmosfera familjare dhe takimi me bashkatdhetarët e fshatit tonë e bëjnë të domosdoshëm organizimin e këti manifestimi edhe në vitet tjera.

Gjithashtu duhet faliminderuar shum vullnetarë të cilët ndihmojn në mbarvajtjen e manifestimit.

Të gjithve antarëve u dërgua ka një DVD me incizimin e manifestimt.

Projektet e ardhshme në vitin 2015

5. Ndërtimi i Shtëpis

Në mbledhjen e fundit më antarët e Shoqatës dhe bashkatdhetarët, e mbajtur më 23. Nëntor 2014 në Aarburg, të pranishmit mbështetën njëzëri, iden e propozuar nga ana e kryesisë, për ndërtimin e një shtëpie për djemt e Muhamedit, Ismailin dhe Imerin. Të pranishmit vendosën që buxheti i shoqatës të mos ngarkohet, mjetet e novjshme të mblidhen në menyrë vullnetare nga të gjith bashkatdhetarët të cilët duan të kontribuojn në këtë projekt.

Plani ideor, i propozuar nga kryesia e shoqatës, parashihte që ky projekt do të kushtojë 18000 deri në 20000 Franga.

Ndërtimi i shtëpisë do të fillojë në prill të vitit 2015. Në këtë projekt do të marrin pjesë edhe shoqata si motër nga Amerika »Garana e bashkuar «.

Gjithashtu duhet faliminderuar edhe kompanitë ndërtuese nga Garana, të cilat të gjitha shprehën gadishmëri të madhe për këtë projekt. Informacione dhe detaje më të hollësishme rreth këtij projekti do të ketë në raportin dhe mbledhjen e ardhshme, pasi të ket përfunduar projekti.

6. Mirmbajtja e varrezave dhe rrugëve të fshatit

Gjithashtu në mbledhjen e fundit më antarët e Shoqatës dhe bashkatdhetarët, e mbajtur më 23. Nëntor 2014 në Aarburg, të pranishmit mbështetën njëzëri, iden e propozuar nga ana e kryesisë, për të punësuar dy puntorë nga Garana, të cilët do të mirmbajnë të gjitha varrezat e fshatit dhe do të kujdesen për rrugët.

Ky projekt do të realizohet në bashkpunim me Shoqatën në Amerikë, ku secila do të financoj 50% këtë projekt.

Për përzgjedhjen e puntorve do të shpallet konkurs. Të drejtë konkurimi do të kenë të gjithë banorët e fshatit Garana.

Rroga e paraparë vjetore është 3000 Franga në vjet për cdo puntorë.

Informata më të detajuara rreth këtij projekti do të ketë raportin dhe mbledhjen e ardhshme.

Shoqata do të angazhohet që, të gjitha projektet e filluara deri tani edhe në të ardhmen të realizohen me kujdesin maksimal.

Me respekt dhe nderitet

Kryesia e Shoqatës Humanitare Garana

Raport mbi të hyrave dhe daljeve ne vitin 2014

Kontabiliteti 2014	Hyrje CHF	Dalje CHF	Shuma Totale CHF
Antarsia	12.921.60 Fr.		
Sponzorat	4400 .00 Fr.		
Ndihmat		6612.00 Fr.	
Te ndryshme		4298.60 Fr.	
Total	17.321.60 Fr.		
Total-Dalje		10.910.60Fr.	
Shuma Totale	6411.00 Fr.		<u>6411. Fr.</u>



GARANA